



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Mars 2021

Nr: 174

VENDIM

PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR TË FONDACIONIT SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA (FShDPAK) PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të miratojë kërkesën e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara “FShDPAK” për akreditimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas listës të përcaktuar në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI



Data: 23 Mars 2021
Nr.174

“Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të “FShDPAK” për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”